



**PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE**

Nr. 54

Datë: 26. 08. 2021. Ora: 13:30

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Sami Kurteshi, Alim Rama, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Florian Dushi,
Ibrahim Selmanaj, Gordana Zuvij, Rifat Krasniq dhe Čemailj Kurtiši.

SKQZ: Burim Ahmetaj, kryeshef.

ZRPPC: Yll Buleshkaj, drejtor.

Përkthyes: Argjina Misni; Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes Nr. 52/2021.
3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së
4. Aktivitetet e ZRPPC-së:
Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për certifikim të subjekteve politike
- 5. Të ndryshme !**

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kreshnik Radoniqi: Përshëndetje për të gjithë, hapim mbledhjen e 54 të KQZ-së, të gjithë anëtarët jemi prezentë, para vetes e keni rendin e ditës të sotme. A ka diçka lidhur me rendin e ditës ?

Sami Kurteshi: Komiteti për Auditim e ka mbajtur një mbledhje ,por në mbledhjen e radhës duhet me ju njoftuar me e futë në rend te ditës. Edhe një çështje tjetër: dje, megjithatë ka ngjarë diçka këtu, në institucion dhe unë jam i interesuar që këtë çështje ta shtrojë në mbledhjen e KQZ-së si pikë e veçantë e rendit të ditës sepse, ka shkaktuar turbullirë në punë....

Kreshnik Radoniqi: Atëherë, nëse nuk ka dikush diçka tjetër a e votojmë rendin e ditës ?

Kush është për...?

Me vota unanime miratohet rendi. Ndërkohë, shqyrtohet procesverballi i mbledhjes nr. 52: (Florian Dushi: “Në njërin prej mbledhjeve të kaluara, jemi pajtuar që në procesverbal, përveç tjerash, në momentet apo në rastet kur ne votojmë për çështje të ndryshme, të përshkruhet saktë për secilin anëtar mënyra e votimit prandaj ndoshta, do të ishte mirë që përfundimisht me fillua me ndjekë këtë praktikë sepse, në fund të fundit ne jemi organ kolegjal, duhet me pas mundësi me u identifikua në të ardhmen nga kush do që ka interes, prandaj është mirë që për cilëndo çështje me emër të potencohet secilin anëtar të KQZ-së mënyra e votimit. Ndërsa, z. Alim Rama kërkoi të bëhen disa korrigjime teknike rreth procesverbalit. Kreshnik Radoniqi: “Është e vërtetë që lidhur me mënyrën e votimit, të gjithë jemi pajtua me u konstatua për të gjithë se kush ka votue për, kush kundër në procesverbalet e ardhshme. Ilir Gashi: Ju, paraprakisht, është mirë të konstatoji me emër e mbiemër se kush ka votuar për, kush kur në mënyrë që të jetë më e lehtë për procesmbajtësin. Këtë çështje, e përkrahu edhe Çemailj Kurtişi i cili, e vlerësoni normale dhe kërkesë individuale të anëtarëve sepse, ndoshta jo gjithmonë por, nganjëherë ndonjëri dëshiron ta di se si, ka votuar. **Kreshnik Radoniqi :** “Atëherë, unë në çdo votim do të konstatoj kush është kundër, kush është për, kush abstenon...”).

Në fund, me 9 vota për, dhe 2 vota abstenim (Sami Kurteshi dhe Fazli Stollaj), u miratua procesverballi nr. 52/2021.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ-së

Burim Ahmetaj: Sekretariati, është në periudhën e përgatitjes e organizmit të zgjedhjeve që do të mbahen më 17 tetor. Aktualisht, është periudha e shërbimit të votuesve kjo që është në proces e sipër, pra periudha e ndërrimit të qendrave të votimit e cila ka filluar me 20 korrik dhe, do të përfundojë me 7 shtator. Deri me këtë periudhë, pra deri me datën 26 gusht, kanë aplikuar 4402 votues për të kërkuar ndërrimin e qendrës se votimit: përmes platformës online janë 3900 dhe, 486

janë parashtruar nëpër zyre të KKZ-ve përmes formularëve të aplikimit për ndërrimin e qendrës së votimit. Gjithashtu, ka filluar edhe periudha e kundërshtimit dhe e konfirmimit të listës së votuesve, periudhë kjo, e cila ka filluar me 24 gusht dhe, përfundon me 7 shtator. Ndër aktivitete tjera, Sekretariati është edhe me periudhën e kthimit të përgjigjeve të cilat kërkon PZAP e që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, përkatësisht me listën e votuesve jashtë vendit. Deri më tani, kemi pranuar 535 kërkesa për përgjigje në apele, prej tyre 530 janë për mos përfshirjen e tyre në listën e votuesve jashtë vendit, ndërsa 5 kërkesa janë për përgjigje në apele për mos përfshirje të kandidatëve.

KQZ, tha z. Ahmetaj, deri më tani për të gjitha këto apele të cilat janë drejtuar në PZAP. Po ashtu, kemi bërë edhe kontraktimi i fletëvotimeve: janë zhvilluar të gjitha procedurat për kontraktimin për shtypjen e tyre. Është dhënë njoftimi për dhënien e kontratës që është publike dhe tani, mund të konsiderojmë se jemi shumë afër nënshkrimit të kontratës për shtypjen e fletëvotimeve.

Ndër aktivitetet tjera të Sekretariati, është edhe identifikimi i vendvotimeve të cilat mund të jenë edhe i njëjti lokacion ku Ministria e Shëndetësisë i përdor si qendër të vaksinimit nga lista e cila ka dërguar te KQZ me lokacione të cilat shërbejnë për vaksinim. Pas analizimit dhe identifikimit, rezultoi që vetëm salla “1 Tetori” e cila gjendet në Prishtinë, është qendër e votimit e miratuar nga KQZ, ndërsa lokacionet tjera nuk ndërlidhen me procesin e votimit.

Aktualisht, tha z. Ahmetaj, jemi në fazën e identifikimit të lokacionit më të afërm me qëllim që të bartim të gjithë ata votues në një lokacion tjetër ku mund të jenë njëri prej fakulteteve që janë në kompleksin universitar mirëpo në lidhje me këtë do të ju njoftojmë edhe në mbledhjet e radhës me identifikimit të lokacionit, po ashtu duhet ti kushtohet rëndësi të madhe edhe informimit të votuesve për ndërrimin e lokacionit të qendrës së votimit ,pra në pika të shkurta këto janë aktivitetet që janë duke u zhvilluar në Sekretariat...

Alim Rama: Kam një çështje lidhur me periudhën e sfidimit dhe kundërshtimit të votuesve për votim nga jashtë Kosovës. Nuk është sipas kërkesës së Këshillit për Informim Publik që të jetë e publikuar në ballinë të ueb faqes. Pra, është një procedurë mjaft e komplikuar për me gjet atë, edhe së dyti, mungon procedura e shkurtër të procesi i ankesave! Ne, mundemi me nënkuptua që personat, a munden apo jo me u ankuar në PZAP. Veçse, ish dashur me pas një informatë të shkurtër se si bëhet procedura e ankesave. Kërkoj nga Sekretariati që këto të korrigjohen...

Florian Dushi: Nga ajo që dëgjuam prej krye shefit, do të thotë kemi rreth 530 përgjigje të cilat i janë dërguar PZAP-së në emër të përgjigjeve ndaj apeleve që janë ushtruar për mos përfshirje dhe kjo ka të bëjë me votuesit jashtë. Tash, unë po konsideroj se si Sekretariat keni pas mundësi me i pa këto apele që janë ngritur dhe më intereson ta di se, në të kaluarën ka ngjarë kjo, nëse apelet janë ushtruar individualisht prej secilit, apo subjektet politike e kanë marrë përsipër këtë rol në emër të këtyre individëve me i ushtrë këto apele...

Burim Ahmetaj: Rekomandimet nga z. Rama, do të merren parasysh dhe do ti marrim të gjitha veprimet sipas kërkesës që edhe janë të qëndrueshme ndërsa, sa i përket apeleve apo qëndrimeve në apele, nuk i kemi të detajuar këto kërkesa! Megjithatë, në mbledhjen e radhë mund ta kemi një raport më në detaje...(nuk dëgjohet)

Kreshnik Radoniqi: Po vazhdojmë me aktivitetet e zyrës...

3. Aktivitetet e ZRPPC-së:

Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimeve për certifikim të subjekteve politike:

Yll Buleshkaj: Ne, kemi punuar në procesin e pastrimit të listave në kuptim të shqyrtimit të tyre, dhe në rregullimit të këtyre listave me institucionet tjera që kanë qenë përgjegjëse për të na dhënë informata në bazë të nenin 29 të ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Para jush, kemi përgatitë një listë të subjekteve të cilat, kanë plotësua kushtet me kandidatët e tyre për tu certifikuar ku nuk përfshihen subjektet e mëdha politike. Janë subjektet politike të cilat, ose nuk kanë pasur ndonjë feedback negativ nga KGJK-ja, ose i kanë larguar (nuk kuptohet). Ne si zyre, i kemi pranuar edhe përgjigjet nga institucionet e tjera por, asnjë nga kandidatët nuk kanë ra ndesh me ligjin, ta zëmë as nuk është ndonjë kandidat polic, agjent i AKI-së apo pjesëtar i FSK-së, madje qoftë edhe i diplomacisë...

Tash, tha z. Buleshkaj, nëse e dini me pranimin e shkresave nga KGJK-ja edhe institucionet e tjera, ne informatën menjëherë ua kemi bartë subjekteve politike duke i këshilluar se në qoftë se kandidati mbetet ashtu siç është, atëherë zyra do të rekomandojë mos certifikimin. Shumica e subjekteve politike, i kanë ndërruar me kandidatët e tjerë për kandidatët e rinj. Jemi në proces të verifikimit dhe për këtë arsye, nuk e kemi listën totale mbi 90 subjekte. Por, para jush e kemi këtë listën prej 51 subjekteve, pjesa tjetër po besoj të shtunën do të finalizohet. Ne, mund ti hyjmë me radhë një nga një subjekteve politike në qoftë se, keni ndonjë pyetje: edhe pse ndoshta vonë ju kanë ardhur rekomandimet....

Rifat Krasniq: Unë, vetëm deshta drejtorin me pyet se për çka partia e turqve KDTP që, është përfaqësues në parlament dhe në çdo komunë që e kanë në asamble, këtu nuk është asnjë, a janë dy parti që janë formuar tash të reja...?

Ylli Buleshkaj: Partia që ju e cekët, ka pas probleme me dy kandidatë. Ata janë zëvendësuar dhe janë në proces të verifikimit...

Florian Dushi: Po besoj që drejtori ishte i qartë: ato që kanë qenë dhe janë përgatitë për këtë takim i kemi këtu përndryshe, edhe unë kisha pas me u ankue, subjektet ma të vogla, mandej tjetër...! Po ashtu, unë kisha me përgëzua zyrën për punën që ka bërë, sepse është një punë mjaft e madhe me

numër të madh të kandidatëve prandaj, unë i uroj këto subjekte dhe tjerat që kanë me u certifikue me pas sukses në zgjedhje...

Kreshnik Radoniqi : Po fillojmë z. Buleshkaj sipas listës urdhëro ?

Ylli Buleshkaj: Radhitja ashtu si kanë ardhë: Lëvizja qytetare Vatra ka aplikue e para dhe e kemi shqyrtuar të gjithë dokumentacionin. I ka 26 kandidatë për kuvend komunal dhe një për kryetar komune. Aplikon vetëm për komunën e Gjilanit...

Kreshnik Radoniqi : Atëherë, nëse nuk ka dikush diçka për këtë subjekt politik? Kush është për certifikimin e kësaj partie politike lëvizja qytetare Vatra ?

Me 11 vota për, certifikohet partia politike lëvizja qytetare Vatra për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Me radhë, është Partia Demokratike e Unitetit e cila, garon në Pejë me kandidat për kryetar komune dhe 2 kandidatë për asamble.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush dikush diçka kundër e hedhim në votim. Kush është për certifikimin e partisë politike Partia Demokratike e Unitetit.

Me 11 vota për, certifikohet partia politike Partia Demokratike e Unitetit.

Ylli Buleshkaj: Partia e radhës, është Partia Rome e Bashkuar e Kosovës e cila garon për Kuvendin komunal në Prizren me 3 kandidatë.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush deklaram, kush është për certifikimin e kësaj partie ?

Me 11 vota për certifikohet partia politike Partia Rome e Bashkuar e Kosovës për zgjedhjet lokale 2021

Ylli Buleshkaj: Gragjanska Iniciativa Gore, është partia e radhës e cila garon për kuvendin Komunal në Dragash me 6 kandidatë.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka, kush është për certifikimin e kësaj partie?

Me 11 vota për certifikohet partia politike Grajancke Iniciativa Gore për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Partia e radhës, është Jedinstvena Goranska Partia, e cila garon në kuvendin komunal

Në Dragash dhe Prizren me 34 kandidatë si total

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka, kush është për certifikimin e kësaj partie ?

Me 11 vota për, certifikohet partia politike Jedinstvena Goranska Partia për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Partia tjetër është partia Kosova Adalet Turk Partisi e cila garon për kuvendin Komunal në Mamushë me 17 kandidatë dhe një për kryetar komune

Kreshnik Radoniqi : Nëse nuk ka dikush diçka me deklarua, kush është për certifikimin e kësaj partie ?

Me 11 vota për certifikohet partia politike Kosova Adalet Turk Partisi për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Nasha Inicijativa, parti politike nga Prizreni garon për kuvendin komunal në Prizren me 17 kandidatë për kuvend komunal.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka kundër ? Po urdhëro z, Dushi ?

Florian Dushi : Tash, në këto raste si kjo Nasha Iniciativa me thanë të drejtën, e kemi të paqartë nëse janë përfaqësues i komunitetit serb, goran, boshnjak...Nëse e keni këtë informatë, na e jepni në rastet kur na emrin nuk po mundemi me e kuptue...

Ylli Buleshkaj: Kjo parti politike e përfaqëson komunitetin boshnjak.

Kreshnik Radoniqi: Dikush a ka diçka tjetër ? Kush është për certifikimin e kësaj partie ?
Me 11 vota për, certifikohet partia politike Nasa Inicijativa për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Partia e radhës është partia Fjala e cila garon në Prishtinë dhe Prizren. Në Prishtinë e ka edhe kandidatin për kryetar komune. Garon me 16 kandidatë...

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka ? Kush është për ?
Me 11 vota për, certifikohet partia politike Fjala për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Partia Balliste është parti e cila garon në Pejë dhe Prishtinë me 6 kandidatë për kuvend komunal dhe nga një kandidatë për secilën komunë.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ?
Me 11 vota për, certifikohet partia politike Partia Balliste për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Partia e dhjetë me radhë sot është partia SDU e cila përfaqëson komunitetin boshnjak të Kosovës, garon në Prizren në kuvendin komunal me 16 kandidatë.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për certifikimin e kësaj partie në qoftë se nuk ka dikush diçka ?
Me 11 vota për certifikohet partia politike SDU për zgjedhjet lokale.

Ylli Buleshkaj: Partia politike Pokret za Gore garon në Dragash me 4 kandidatë të kuvendit Komunal dhe përfaqëson komunitetin goran të Kosovës.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për certifikimin e kësaj partie në qoftë se nuk ka dikush diçka ?
Me 11 vota për, certifikohet partia politike Pokret za Gora për zgjedhjet lokale.

Ylli Buleshkaj: Partia e radhës, është Jeniliksi Turk ARK Partisi e cila garon në Prizren me 12 kandidatë.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka kundër? Kush është për ?
Me 11 vota për, certifikohet partia politike Jeniliksi Turk ARK Partisi për zgjedhjet lokale 2021

Ylli Buleshkaj: Partia e radhës, është Partia Liberale Egjiptiane e cila garon në Pejë në Kuvendin Komunal me 9 kandidatë.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka kundër? Kush është për ?
Me 11 vota për, certifikohet partia politike Partia Liberale Egjiptiane për zgjedhjet lokale 2021

Ylli Buleshkaj: Partia e radhës është Balli Kombëtar i Kosovës që garon për kuvendin Komunal në Deçan dhe Dragash, dhe për kryetar komune ka edhe në Dragash një kandidat. Ka 4 kandidatë për kuvende komunale në dy komuna...

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka kundër? Kush është për ?
Me 11 vota për, certifikohet partia politike Balli Kombëtar i Kosovës për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës, parti që përfaqëson komunitetin egjiptian të Kosovës. Garon për kuvendin komunal në Gjakovë dhe Istog me 22 kandidatë.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka kundër? Kush është për ?
Me 11 vota për, certifikohet partia politike Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Partia politike që përfaqëson komunitetin boshnjak Nova Demokratska Stranka garon në Prizren për kuvend komunal dhe kryetar komune. Me 24 kandidatë për kuvend komunal, dhe një për kryetar komune.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka kundër? Kush është për ?
Me 11 vota për certifikohet partia politike Nova Demokratska Stranka për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Partia Socialdemokrate garon në Kamenicë për kryetar komune dhe kuvend komunal: me 29 kandidatë për kuvend komunal, dhe një për kryetar komune.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka kundër? Kush është për ? Me 11 vota për certifikohet partia politike Partia Socialdemokrate për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës ka kandidatë për kuvendin komunal në Gjakovë dhe Klinë, ndërsa në Klinë ka dhe kandidat për kryetar komune. Kandidon me 45 kandidatë për kuvendet komunale në këto dy komuna, dhe një kandidat për kryetar komune në Klinë.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për certifikimin e kësaj partie?

Me 11 vota për, certifikohet partia politike Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Koalicioni VAKAT garon në komunën e Dragashit e Prizrenit, për kuvende komunale, ndërsa për kryetar komune në Dragash. Për kuvende komunale, i ka 28 kandidatë, ndërsa e ka kandidatin për kryetar komune në Dragash.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka kundër? Kush është për ? Me 11 vota për certifikohet koalicioni Koalicija Vakati për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Lista Guxo është certifikuar si subjekt politik, ndërsa sot certifikohet edhe kandidati i tyre për kuvendin komunal në Ferizaj.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka kundër? Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet iniciativa qytetare Lista Guxo për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa tjetër qytetare Ne Mundemi për të garuar në kuvendin komunal në Ferizaj, me 22 kandidatë.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për certifikimin e kësaj iniciative ? Me 11 vota për, certifikohet iniciativa qytetare Ne Mundemi për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa tjetër qytetare Bashkë për Istogun, e cila është certifikuar si subjekt politik, ndërsa ka 13 kandidatë për kuvendin Komunal në Istog dhe kryetar komune.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për?

Me 11 vota për, certifikohet iniciativa qytetare Bashkë për Istogun për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa e radhës është Iniciativa Qytetare për Obiliq e cila garon për Obiliq ka 23 kandidatë për kuvend komunal dhe një për kryetar komune.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për?

Me 11 vota për, certifikohet iniciativa qytetare Iniciativa Qytetare për Obiliq për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa e radhës është Iniciativa Qytetare Bashkë për Shtëpcën, ka 17 kandidatë për kuvendin komunal dhe një për kryetar komune.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për?

Me 11 vota për, certifikohet Iniciativa Qytetare Bashkë për Shtëpcën për zgjedhjet lokale 2021

Ylli Buleshkaj: Iniciativa e radhës është Iniciativa Qytetare për Mogillën në Kllokot e cila ka 4 kandidatë për kuvend komunal në Kllokot.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për?

Me 11 vota për, certifikohet Iniciativa Qytetare për Mogillën për zgjedhjet lokale 2021

Ylli Buleshkaj: Iniciativa e radhës është Grajancka Initiative Sloboda Shterpce e cila garon me 6 kandidatë për kuvend komunal dhe një për kryetar komune.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për?

Me 11 vota për, certifikohet iniciativa qytetare Gragancka Iniciativa Sloboda Shterpce për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa qytetare Unioni i Blakqorrve për të garuar për kuvendin komunal në Podujevë.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për certifikimin e kësaj iniciative ? Me 11 vota për, certifikove Unioni i Blakqorrve për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa qytetare Iniciativa Qytetare Boshnjake për Istog kërkon certifikim të 11 kandidatëve të kuvendit komunal për Istog.

Kreshnik Radoniqi: Nëse nuk ka dikush diçka kundër, kush është për, me 11 vota për certifikohet Iniciativa Qytetare Boshnjake Istog.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa qytetare “Grin” për Drenas, e cila garon ne kuvendin komunal dhe për kryetar kuvendi ne Drenas 22 kandidate i ka për kuvendin komunal ne Drenas.

Kreshnik Radoniqi: Nëse s'ka dikush kundër kush është për ? Me 11 vota për certifikohet iniciativa qytetare "Grin" për Drenasin për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa e radhës është Iniciativa për Zubin Potok që ka kandidat për kryetare komunë dhe 5 kandidatë për kuvendin komunal edhe këta e kanë kryer të gjitha obligimet që është dashur të i kryen

Kreshnik Radoniqi: Kush është për certifikimin e kësaj iniciative. Me 11 vota për, certifikohet Iniciativa qytetare Grqanicka për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa qytetare Aleanca Shqiptare garon në Gracanicë për kuvendin komunal me 3 kandidatë dhe kërkona të certifikohet sepse ka kryer të gjitha obligimet.

Kreshnik Radoniqi: Atëherë kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet iniciativa qytetare Aleanca Shqiptare për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Lëvizja Përparimtare Rome për Kosovën kandidon me 9 kandidat për kuvendin komunal të Përzierit...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për certifikimin e kësaj iniciative? Me 11 vota për, certifikohet iniciativa qytetare Lëvizja Përparimtare e Romeve të Kosovës për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa qytetare, Iniciativa për Fushë Kosovë Egjiptian, Hashkali ka kërkuar që të certifikohet me 16 kandidatë për kuvend komunal në Fushë Kosovë, këta i kanë kaluar të gjitha filtrat dhe rekomanduar për certifikim.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për certifikimit të kësaj iniciative ? Me 11 vota për, certifikohet iniciativa qytetare, Iniciativa për Fushe Kosovë Egjiptian dhe Aashkali për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa e radhës o Iniciativa boshnjake në Istog dhe Pejë. Kanë 19 kandidat në total, dhe rekomandohet që të certifikohen. Kanë kaluar edhe shqyrtimin e brendshëm edhe të jashtëm...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për certifikimin e kësaj iniciative ? Me 11 vota për, certifikohet iniciativa qytetare Iniciativa Boshnjake për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa qytetare Lista e Hashkalive, është një listë e përbashkët në Ferizaj që garon me 11 kandidatë për kuvendin komunal në Ferizaj.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet iniciativa qytetare Lista e Ashkalive për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa qytetare për ndryshime nga Podujeva kërkon që t'i certifikojë 3 kandidatë të cilët, rekomandoj për t'u certifikuar.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet Iniciativa Qytetare për Ndryshime për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Iniciativa e radhës është iniciativa “Boshnjaqka” e cila kërkon të certifikojë 8 kandidatë për kuvendin komunal të Pejës .

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet iniciativa qytetare “Boshnjakqka” për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Tani po kalojmë tek kandidatet e pavarur. E kemi kandidatin Milazim Lushaj i cili garon për Prizren, edhe ky i ka kryer filtrat ligjore dhe rekomandohet për certifikim.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidati i pavarur Milazim Lushaj i cili garon në zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Njëjtë kandidon edhe kandidati Rufki Sumaj për kryetar të komunës së Hanit të Elezit. Rekomandohet për tu certifikuar...

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidati i pavarur Rufki Sumaj për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Kemi kandidatin e pavarur Iliaz Bajraktari i cili rekomadnojmë të certifikohet si kandidatë për kryetar komunë në Mashushë.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidati i pavarur Iliaz Bajraktar për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Jeton Salihu kërkon të certifikohet si kandidatë për kryetare komune në Vushtrri.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidati i pavarur Jeton Salihu për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Branimir Stajanoviq rekomandohet për tu certifikuar si kandidatë për kryetar komunë në Graçanicë.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidati i pavarur Branimir Stajanoviq për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Kandidati i pavarur Jugosllav Jovanoviq kërkon që të certifikohet si kandidat për kryetare komune në Partesh.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidati i pavarur Jugosllav Jovanoviq për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Gani Neziri nga Gjilani, rekomandohet që të certifikohet si kandidat për kryetar komune në Gjilan.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidati i pavarur Gani Neziri për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Sllogjana Pantoviq kandidate për kryetare komune dhe kuvend komunal në Zveçan i ka kryer të gjitha procedurat dhe, rekomandohet për tu certifikuar për këto dy gara.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidatja Sllogjana Pantoviq për zgjedhje lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Lulzim Bexheti rekomandohet që të certifikohet si kandidate për kryetar komune në Gjilan.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidati i pavarur Lulzim Bexheti për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Patriot Rudari, rekomandohet për tu certifikuar si kandidate i pavarur për kryetar komune në Podujeve.

Kreshnik Radoniqi: Urdhëro z. Kurteshi...

Sami Kurteshi: (Nuk dëgjohe...)

Kreshnik Radoniqi: Atëherë kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidati i pavarur Patriot Rudari për zgjedhjet lokale 2021 për kuvendin komunal në Podujevë.

Ylli Buleshkaj: Smajl Mustafa rekomandohet të certifikohet si kandidate për kuvendin komunal në Drenas.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidati i pavarur Smajl Muastafa për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Gani Veselaj rekomandohet për tu certifikuar si kandidat për kryetar komune në Pejë.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për ? Me 11 vota për, certifikohet kandidati i pavarur Gani Veselaj për zgjedhjet lokale 2021.

Ylli Buleshkaj: Tani i kemi dy kandidat të cilët rekomandohet nga zyra që të mos certifikohen sepse janë identifikuar nga KGJK-ja që janë në mos përputhje me shkronjën “GJ” të nenit 29 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Po kërkoj që kjo mu tërheqë në mënyrë që ta fusim në rendin e ditës në takimin e ardhshëm sepse, mundet të jete gabim teknik, më mirë ta sqarojmë edhe njëherë...

Kreshnik Radoniqi: Në rregull vetëm sa për proces rekomandimi për certifikimin e kandidatit te pavarur Gani Veselaj tërhiqet nga zyra për rivlerësim dhe korrigjim dhe, do të jetë çështje që trajtohet në mbledhjen e radhës.

Ylli Buleshkaj: Tani kemi dy kandidate te cilët rekomandohen nga zyra qe te mos certifikohen janë kandidate te pavarur Fatmir Hasani dhe kandidati i pavarur Xhavit Murati. Kandidati Fatmir Hasani ka kërkuar që të certifikohet për Mitrovicën e Jugut, ndërsa Xhavit Murati për Prishtinë. Arsyeja që nuk rekomandohen për tu certifikuar është se nga KGJK-ja kemi pranuar informata që këta të dy kanë vendime të formës së prerë në 3 vitshin e fundit për vepër penale. Dhe, në respektim të shkronjës “S” rekomandohet që të mos certifikohen...

Kreshnik Radoniqi: Këtë herë kush është për mos certifikime...? Urdhëro z. Dushi...?

Florian Dushi: Faleminderit, drejtori e prezantoi rekomandimin e tij ne rregull por megjithatë këtu është thënë nuk certifikohet mendoj që edhe në këto shkresa mendoj që është mirë për të thënë nuk rekomandohet për certifikime.

Kreshnik Radoniqi: Atëherë kush është për mos certifikimin, refuzimin e certifikimit te kandidatit te pavarur Fatmir Hasani. Me 11 vota për, kandidati i pavarur Fatmir Hasani nuk certifikohet për zgjedhjet lokale 2021.

E kemi rekomandimin për mos certifikim të kandidatit të pavarur Xhavit Murati. Kush është për që të mos certifikohet ky kandidat ? Atëherë me 11 vota për, kandidati i pavarur Xhavit Murati nuk certifikohet për zgjedhjet lokale 2021.

Me qaq përfundoj pjesërisht. Për pjesën tjetër të partive, subjekteve politike do të i trajtojmë në mbledhjet e radhës që do ta kemi sipas të gjitha gjasave, të shtunën nëse zyra ka nevojë të premtën dhe pjesën e pare të ditës se shtunë për me i përgatitur të gjitha rekomandimet...Atëherë, kalojmë në të ndryshme!

4. Të ndryshme!

Kreshnik Radoniqi: Urdhëroni z. Kurteshi...? E patët një pikë lidhur me incidentin e djeshëm... Megjithatë, unë do ta jap fjalën por, kisha kërkuar, me qenë se tashmë edhe organet e rendit janë duke u merr me çështjen, unë thjeshtë nuk do te flas asgjë lidhur me këtë pikë, organet e rendit i dinë punët e veta, ata do të vijnë me një konstatime se çfarë ka ndodhe, ka pasur dëshmitare të mjaftueshëm...Ju kisha lutur edhe juve me qenë pak të përmbajtshim sa i përket ngjarjes, por ju mund ta shprehni një sqarim...Urdhëro...?

Sami Kurteshi: Faleminderit! Dje ka ngjare diçka, d.m.th., ata e kanë paraqitur si përlëshje fizike...Unë, me qenë se shumicën e këtyre portaleve nuk i përcjell hiq, as nuk kamë parë asgjë, dhe pastaj kam dëgjuar se e kanë involvuar policinë dh prokurorinë...Ani, shumë mirë, edhe unë kame qenë dhe kam dhënë një deklaratë. Çka ka n'gja, kjo është ligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë në territorin e Republikës së Kosovës. Neni 10, thotë se masat për mbrojtje nga pandemia, çdo person në institucione publike, private apo publike - private ka për detyrë që t'i zbatojë, pra masat e përcaktuara nga organet kompetente për mbrojtje nga covid. Neni 11: masat e përgjithshme; njëra prej këtyre masave në piken 1.4 thotë: mbajta e maskën! Neni 12: masat e veçanta; njëra prej tyre është izolimi dhe karantina për ata që konstatohet që janë prekur nga covid. Përveç kësaj, në piken 4.7 thotë: mbyllja e aktiviteteve jo publike apo publike d.m.th, nëse dikush konstatohet se është infektuar dhe kemi pasur kontakt me te...ne, sipas ligjit dhe vendimit të Qeverisë, jemi të obliguar ta përdorim, kjo është çështja... Neni 19, thotë: personat e sëmurë pozitive me covid, u ndalohe veprimtaria në punë dhe në aktivitete të tjera ku mund ta rrezikojmë shëndetin e personave te tjerë.

Ne, e themi se duhet me u izoluar, dhe natyrisht, në paragrafin 5, thuhet: nuk lejohet qarkullimi i personave për të cilët dyshohet se janë të sëmurë...! Edhe në nenin 26, e kemi izolimin dhe karantinimin e personave që janë sëmurë...Mundem me ua lexuar, është paragrafi 1, pika 1.4 edhe masat, d.m.th, me vendimin e Qeverisë, më 18 gusht thuhet..., vendimi është për masat e përgjithshme dhe të veçanta për kontrollin, parandalimin dhe luftimin e pandemisë që të zbatohen në tërë territorin e republikës se Kosovës...

Masat e përgjithshme janë: obligohen institucionet publike dhe private dhe subjektet tjera që, në hyrje të çdo objekti të vendosen shenja të dukshme të rregullave të sjelljes për mbrojtje nga covid 19, përfshirë edhe shenjat e ndalimit të hyrjes në objekt pa maskë, si dhe respektimin e distancës, dhe ky ishte paragrafi katërt, ndërsa në paragrafin 5 thuhet: ndalohe hyrja në ambientet e mbyllura pa maskë, këto janë norma ligjore se secili njeri jo shtetas po njeri, në territorin e Republikës së Kosovës, obligohet...

KQZ-ja, është institucion i pavarur për zgjedhjet dhe, duhet të zbatojmë ligjet që nxirren në mënyre të rregullt për republikën e Kosovës dhe vendimin secili prej nesh përveç tjerash e ka obligime për me mbrojtje jetën e vete dhe shëndetin e vete.

Unë, jam shumë i interesuar që të mbroj shëndetin tim dhe jetën time dhe të tjerave mundem të them se më së paku 5 here në mbledhje te KQZ-së kam kërkuar respektimin e rregullave: mbajtjen

e maskës. Në mbledhjen para kësaj të 53 të, e kemi në procesverbalin shprehimisht, e kam kërkuar këtë, e kam kërkuar nga 2, 3 persona flitet në procesverbal që ta lëshojnë sallën sepse, nuk kane maske dhe ata kane qene edhe dy kameraman te mediave mund ta marr me mend... Kjo është hakmarrje, nuk është me rendësi, unë e kam kërkuar këtë që të shohim mundësin të mbajmë mbledhjet në këtë salle për shkak të distancës hapësirën më të madhe me ruajte shëndetin tonë dhe të tjerëve, përndryshe, ne duhet të izolohehi si institucione edhe zgjedhjet ti ndërpresim sepse, ne jemi të pakujdesshëm, të pa ndërgjegjshëm...Unë këtë nuk po dua me lejua më së pari për shëndetin tim, edhe për jetën time, edhe të tjerëve po, kryesorja është që në funksionimin e institucionit, dje unë kom pasur mbledhje të komunitetit të auditimit edhe në ora 09:50, kam ardhur në institucion Tu hy në zyre, aty afër, është një automatik i kafes edhe rastësisht e kam pa një djalë që nuk ja di emirin ende sot. Ai është pak i shëndosh, pa maskë dhe vetëm e kam pyetur: O djalë ku e ke maskën ? Ndoshta ka ba zë por nuk e kam dëgjuar, kam thanë ku e ke maskën, vendose maskën. Jo tha as nuk kam as nuk e vendosi, qysh nuk e vendos qysh nuk ki ! A se vendos thash, ti duhesh me dal jashtë. Tha as s'dal jashtë as se vendosi, dhe unë natyrisht jam shkuar e kam marr dhe e kam qitë jashtë. Ka dal jashtë ai, nuk ka pasur kundërshtime, nuk ka pasur as konflikt verbal as sharje, fyerje...Janë kanë nja 7 apo 8 veta në korridor.

Unë kam bëritë me qëllim me më dëgjuar krejt, unë po ju them tani me shkuar në korridor poshtë, ka persona të institucionit që ecin në institucionin pa maske, unë kapërcej nëpër qatë korridor edhe unë po dua me ruajtur shëndetin tim prandaj, arsyeja ka qenë se ai ka dal jashtë, nuk ka pasur kundërshtime...Nuk e di a ka pa dikush diçka por, siç duket kanë njoftuar mediat që s'kanë etikë profesionale gazetareske po, kanë etikë kriminale...Po, ajo nuk është me rendësi, unë nuk i përcjelli, unë nuk kam ditur asgjë, e kam mbajti mbledhjen dhe kur kam dal, e kam parë atë...Ai djali, ishte i punësuar, nuk e di emirin por, ishte i punësuar këtu...Me gjasë përkohësisht, unë nuk e kam njohtë së paku dje më ka ra në sy, më shumë kur ka dal jashtë e ka vendosur maskën dhe, u rikthyer te dera e hyrjes dhe aty tek dera e hyrjes ne e kemi njëfarë...Më duket jashtë, është njëfarë letre që tregon që duhet me pasur maskë. E, ai ishte një person ose se paku aty ke ulur që duhet me ndjetë aty, dhe me i orientuar palët që vinë në KQZ-ë te kush me shkuar e qysh por, i ka edhe maskat aty afër me ju rekomanduar me vendos maskën kur të hyjnë në institucion...

Ai, ishte person përgjegjës, e ai thotë as se kam, as se vendosi maskën...As nuk dal jashtë, e unë mundem me marr me mend është në literaturën ruse një thënie që thotë se ata që e rrahin gjoksin janë të fort sepse, e kane gjoksin e fortë dhe e kanë shpinën e fort prandaj, e rrahin gjoksin...Unë mundem me e marr me mend qe, ai e ka një shef këtu të madh, ka të njohshëm edhe thotë nuk dëgjoj unë për askënd...

Aty punon edhe një djalë pak më i dobët, dhe kjo është thelbi i kësaj që e ka shpinën e fort dhe, ka një të fortë këtu, nuk e di kush është...! Në fund, ata munden me tregu tash, ai më tregon mua se nuk e përfill asnjë kërkesë timen..., ti je staf politik, t'i nuk ki të drejtë me dhanë, me më urdhëruar...Ai, nuk është urdhër, por në këtë institucion duhet me e zbatua ligjin, unë e kam për kurajë me e than, ti e ke për detyre me zbatua ligjin...Unë po dua me e mbrojte jetën dhe shëndetin tim...Dil në rrugë, në shpi tënde, ba çka të duash por këtu jo, se këtu unë skam ku me ikë në

rrugë...Unë kam qenë në polici, kam dhënë një deklaratë, e kanë dhënë edhe ata një deklaratë...E rrjedhin informacione të qëllimshme prej këtu, gënjeshtër por, edhe prej mediave po rrjedhin informata...Dikush prej tyre po thotë: jo, kjo ka ardhur prej institucionit nga brenda, dikush jo nuk ka ardhur as prej atyre djemve por prej dikujt brenda dhe, sigurisht brenda është ai që e ka futë këtë që e ka punësuar këtu, që ja ka rreh shpinën: ti mos e ki dert, unë jam këtu herën e ardhshme mundem edhe me emër me qitë kush janë ata, po qysh po rrjedhin informacionet edhe prej kujt po rrjedhin edhe prej atje, Sami dikush që se di një emër...unë, dje e kam pa që më kanë thirrur nja 50 media, por unë nuk ju përgjigja...

Unë në mënyrë kolegjiale kërkoj me e mbrojtë jetën dhe shëndetin dhe me mbrojtë punën e institucionit, asgjë nuk kërkoj tjetër, dhe hiq askënd nuk e urdhëroj në mënyrë kolegjiale...Edhe sot kërkoj, edhe nesër kërkoj deri sa këto masa të jenë në fuqi, edhe deri sa numri i të infektuarve është mbi 2500, dhe i të vdekurve është 15 – 16, ky është problemi...Unë i kam thënë secilit: të lutem vendose maskën, zbatoje ligjin, ai nuk e zbaton ligjin...Unë e di që te ne është pak problem... “Marigona është vra se s’ka guxuar me lajmëruar një kriminel që bënë vepra, as në shpi as askund se pastaj, të gjithë i gjuhen në qafë, edhe thonë: ah ti po e lajmëron, ai ka pas 136 vepra dhe kur e ka parë ajo që as policia si bënë asgjë, as gjykata jo, as prokurori jo, ku guxoj me lajmërua unë këtë...”

Unë, po e sqaroj sepse, unë nuk i përgjigjem atyre që quajnë veten media ose atyre media, unë në telefona nuk i përgjigjem, çka ka me thanë, unë e them publikisht edhe hynë në procesverbal...Jashtë këtu, nuk thamë asgjë, as nuk dal në media askujt me ja përmend emrin...Kur kam nevojë, unë e organizoj një konferencë për shtyp por kjo nuk është konferencë për shtyp! Dje, nuk ka pasur as konflikt verbal, dje nuk ka pasur as konflikt fizik, dje nuk ka pasur asnjë fjalë e fyerje apo sharje, dje nuk ka pasur as kundërshtime...Unë kam kërkuar me dal, dhe e kam nxjerrë atë djalin jashtë. Tani po kërkoj nga këtu: në mbledhjen e fundit kemi marr vendim dhe krye shefi e ka pasur për detyrë me zbatuar atë vendim: në institucione tonin askush pa maske nuk mundet me qëndruar në institucione, pa përfill ligjet edhe vendimet...Dhe ai del e thotë: jo, unë nuk dëgjoj për ty!

Procesverbali kur të vjen z. krye shef, e keni për detyrë me ja dërguar policisë edhe prokurorit atë që kemi thanë.... Mirë kishte me qenë me marr edhe procesverbalet tjera se, sa herë kam kërkuar me i zbatuar normat ligjet, mirë kishte me qenë..., edhe me e pa që nuk e kam pasur me një person të caktuar që nuk ja di as emirin, po e kam për shëndetin tim, për jetën time edhe për punën e institucionit...Unë, nuk jam i interesuar në këtë kohë institucioni me u izoluar sepse, i kemi zgjedhjet...Nëse ka kapadai me e shkel ligjin, edhe mandej me të lajmëruar, me thanë u ba për prokurori, ata nuk e kane vendin në këtë institucione...Edhe po kërkoj që ata dy persona që thoshin që ne nuk i përfillim urdhrat e stafit politik, ata mos me qëndrua me te dera se janë arrogantë, nuk e respektojnë ligjin, dhe nuk e respektojnë institucionin...Ata, duhet të largohen prej aty menjëherë kur të dalim nga këtu, dhe me i sjell dy persona që e respektojnë ligjin, vendimin dhe që ju thonë njerëzve mos hyni këtu pa maskë se nuk banë....Kaq kisha unë për këtë rast... Faleminderit...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit z. Kurteshi, a ka dikush diçka tjetër...?

Alim Rama: Unë, disa here këtu edhe ne këshillin për personel kam thane te respektohen te gjitha procedurat e punësimit momentin qe ngjan diçka këtu unë kisha kërkuar prej krye shefit ndoshta për mbledhjen e radhës se këshillit te personelit me jep raportin se qysh janë punësuar ata persona nuk mundet askush se kjo nuk është prone familjare tash unë dëgjova jo ky është vëlla' i atij ose asaj për persona po për momentin qe është nepotizëm edhe ngjanë kjo çka ka ngjare dje unë kisha kërkuar një raport ndoshta edhe auditorin qe ti auditon te gjitha këto rekrutime ne kemi caktuar disa kriteret për punësim stafi pra te gjithë ata qe kane ushtruar një funksione te njëjtte, ne qofte se ka pasur rekomandime te mira për ato qe te kthehen ose te tjerat te shkojnë me konkurs ne momentin qe dikush ju vendos ne një pozite tjetër tash unë e di qe ne zgjedhjet e kaluara na kemi pasur kompaninë qe ka qen te dera rolin e receptionistit tash këta janë te punësuar kështu mua po me intereson prej krye shefit a janë zgjedhe këta me konkurse dhe si janë zgjedhe këta. Por edhe për te gjitha pozitat tjera dhe ne moment qe behet punësimi jo i rregullt ndodh ngjanë këto sene ashtu ka ngjare edhe ne QNR-ë ne shkurt te gjitha punësimet duhet me qene transparente dhe te gjithë punësuarit duhet me u punësuar ne baze te meritës. Kjo është një kërkesë e imja. Faleminderit

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit, a ka dikush diçka tjetër...?

Sami Kurteshi: Mediat, duhet të kenë parasysh se, unë nuk përgjigjem për çështje të brendshme publike në mënyre private në telefon, çka të ken në çështje publike unë jam në mbledhje të KQZ-së...Kur të doni ua caktoj edhe një konferencë për shtyp por, harroni që unë e hapi telefonin për çështje private dhe emër privat...

Kreshnik Radoniqi: Faleminderit, takohemi të shtunën në mbledhjen e radhës...